



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.300/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Kadri Krivanjeva, kandidat për Kuvend Komunal në Kaçanik, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 24.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa, ZL. Anr.300/2025 e datës 22.10.2025, parashtruar nga Kadri Krivanjeva, kandidat për Kuvend Komunal në Kaçanik, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025

A r s y e t i m

Me datë 22.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Kadri Krivanjeva, kandidat për Kuvend Komunal në Kaçanik, e dorëzuar në Postën e Kosovës me datën 17.10.2025 në të cilën thekson se me datën 16.10.2025 në KQZ janë publikuar rezultatet për Kuvend Komunal në qendrën e votimit 0706 Stagovë, respektivisht klasa 01, ku në këtë vendvotim janë bërë gabime nga QKN sepse sipas dëshmitarëve okular me përgjegjësi të plote gjatë numërimit vetëm subjektet kanë vërejtur se unë si kandidatë për kuvend komune kamë afër 50 vota e në të cilin vendvotim nga QKN kanë dalë vetëm 15 vota si dhe në vendvotimin në VV 0706/02. Po ashtu sipas parashtruesit të ankesës në vendvotimin 0712/01 Ivaj Kaçanik me përgjegjësi të plotë motra ime deklaroi se më ka votuar, por më kanë dalë 0 votë. I njëjti kërkon rinumërimin e këtyre vendvotimeve, dhe përmend disa persona si dëshmitar.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë: Sa i përket pretendimeve të palës për pikën e parë të ankesës, lidhur me çështjen e kërkesës për verifikim të votave për vendvotimet e lartcekura, ju njoftojmë se: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZPJ) Rregulloren

Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025 Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN, Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Kaçanikut, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: "Gjatë këtij procesi janë ndjekur të gjitha procedurat e parapara gjatë verifikimit dhe numërimit. Gjithashtu ky proces ka qenë i përcjellë nga secili vëzhgues i subjekteve politike por edhe i mediave, secili fletëvotim ka qenë paraqitur në kamerë si dhe në televizor në kohe reale. Nga kjo, nuk kemi marrë asnjë ankesë qoftë nga vëzhguesit apo vete anëtarët e subjekteve politike që kanë numëruar në secilën tavolinë. Gjithashtu edhe stafi i KKZ-se ka qenë vazhdimisht duke monitoruar secilën tavolinë dhe nuk ka vërejtur dhe as marrë asnjë ankesë nga asnjëra palë si vëzhguesit apo edhe vete anëtarët e numërimit, ku janë njoftuar që se procesi është zhvilluar në kuadër të procedurave të përcaktuara ligjore". Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët kanë votuar për të, ky fakt nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, nuk mund të identifikohet mënyra e votimit të asnjë votuesi. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjeve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1,3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Lidhur me pretendimet e palës ankuese për pasqyrim jo të saktë të rezultateve, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevojë të veçantë; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoi se pretendimet në ankesën e Kadri Krivanjeva, kandidat për Kuvend Komunal në Kaçanik, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga dëshmitarët në teren, paneli nuk ka arritur që të vërtetojë se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesë, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se ka gabime në vota apo se të njëjtat i mungojnë, ndërsa pretendime të theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe në prova konkrete.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështeten në deklarinimin e disa personave të identifikuar me emër dhe mbiemër, këto prova nuk janë të besueshme dhe bindëse për të vërtetuar shkeljen e pretenduar, po ashtu sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjë që shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim çon në fshehtësinë e votës.

Andaj Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtuesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr.300/2025 datë 24.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.